



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Vushtrrisë
Opština Vucitrn – Municipality of Vushtrri

Drejtoria e Arsimit

10 Nr. 542/26

Datë: 17.08.2026

Bazuar në Ligjin për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës Nr.04/L-032, Udhëzimin Administrativ Nr.22/2013 “Numri maksimal i nxënësve për klasë dhe raporti mësimdhënës nxënës” dhe bazuar në Kushtet dhe kriteret për regjistrim të nxënësve në klasën e (10) në Gjinnaze dhe Institucionet e Arsimit dhe aftësimit Profesional të shpallura nga MASH, nr. 3/2838 datë: 29.06.2026.

DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT NË VUSHTRRI SHPALL

KONKURS PLOTËSUES

PËR REGJISTRIMIN E NXËNËSVE NË KLASËN E DHJETË (10) NË GJIMNAZ DHE NË SHKOLLAT TEKNIKE DHE PROFESIONALE PËR VITIN SHKOLLOR 2026/27

Planifikimi për regjistrim të nxënësve në klasën e dhjetë (X) për Gjinnazin “Eqrem Çabej” Vushtrri:

SHKOLLA	Drejtimi	Nr. i Paraleleve	Nr. Nxënësve në një paralele	Gjithsej për drejtim
Gjinnazi “Eqrem Çabej” Vushtrri	Shkenca natyrore	1	20	20
Gjithsej:		1	20	20

**Planifikimi për regjistrim të nxënësve në klasën e dhjetë (X) për shkollë Teknike dhe
Profesionale në Vushtrri**

Shkollë	Drejtimi	Profili	Nr. i paral.	Nr. i nxën.
SHMLP "Lumi i Vushtrrisë"	Makineri, prodhim dhe ndërtimtari	Zdrukthtari-DUAL	1	13
		Operator i prodhimit	1	13
		Dirigjimi kompjuterik i makinave	1	14
		Automekanik-DUAL	1	2
		Instalues i ngrohjes, klimatizimit dhe ujesjellesit	1	0
		Trafik rrugorë	1	15
	Teknologji e informacionit dhe komunikimit	Mekatronikë	1	6
		Instalues elektrik - DUAL	1	9
		Energjetikë	1	22
		Zhvillues i aplikacioneve softuerike	1	0
		Teknik i informatikës së biznesit	1	2
		Teknik i sistemeve të TIK-ut	1	10
	SHMLP "Lumi i Vushtrrisë" Vushtrri	Gjithsej:	12	106
SHMLP "Bahri Haxha"	Agrokulturë, pylltari, peshkatari dhe veterinar	Teknologji ushqimore	1	4
	Makineri, prodhim dhe ndërtimtari	Arkitekturë	1	4
		Teknologji e riciklimit	1	6
	Shërbime	Asistent restoranti	1	8
		Kuzhinier	1	6
		Dizajn enterieri	1	8
	SHMLP "Bahri Haxha" Vushtrri	Gjithsej:	6	36

Dokumentet e nevojshme për Aplikim

Nxënësit për të aplikuar për regjistrim në klasën e 10-të në gjimnaze dhe shkolla profesionale, duhet të paraqesin këto dokumente:

- Fletëparaqitjen (e cila merret në shkollën në të cilën aplikon)
- Dëftesën origjinale për kryerjen e shkollës së mesme të ulët (6-9) dhe
- Certifikatën e lindjes.
- Dëftesën e nostrifikuar në MASH (vlen vetëm për nxënësit që kanë mbaruar klasën nëntë (IX) jashtë Kosovës).

Kushtet e përgjithshme për regjistrimin e nxënësve të rregullt

Për regjistrimin e nxënësve në klasën e 10-të, të gjimnazeve dhe të shkollave profesionale, për vitin shkollor 2026/2027, mund të konkurrojnë kandidatët të cilët e kanë mbaruar arsimin e obligueshëm dhe nuk janë më të vjetër se 17 vjeç. Nxënësit, të cilët e kanë mbaruar klasën e nëntë (IX) jashtë Kosovës, obligohen ta bëjnë nostrifikimin e dëftesave në MASH dhe pastaj të konkurrojnë për regjistrim.

Konkursin dhe kriteret e detajuara për secilin drejtim i gjeni të publikuara në shkollat përkatëse dhe në web faqen e Komunës së Vushtrrisë; <https://kk.rks-gov.net/vushtrri/>

Afati i paraqitjes së dokumenteve dhe shpallja e rezultateve

- Paraqitja e dokumenteve për gjimnaze dhe shkolla profesionale për vitin shkollor 2026/2027, bëhet në datat: **17, 18, dhe 19 Gusht, 2026** duke filluar nga ora **8:00-16:00**, në shkollat përkatëse.
- Shpallja e rezultateve më **20.08.2026**
- Tërheqja e dokumenteve për nxënësit, të cilët nuk janë pranuar do të bëhet me 21.08.2026 duke filluar nga ora 8:00-16:00.

AFATI I ANKESAVE

Kandidatët e pakënaqur me rezultatin e publikur, kanë të drejtë ankese në afat prej dy (2) ditë pune, nga koha e shpalljes së rezultateve t'i paraqesin ankesë drejtorisë së shkollës.

Ankesat në shkallën e dytë bëhen në Drejtorinë Komunale të Arsimit brenda dy (2) ditë pune, pas pranimit të përgjigjes nga shkolla.

DKA shqyrton vetëm ankesat, për të cilat shkolla përkatëse ka ofruar përgjigje dhe vetëm në shkallën e dytë.

